



ALEANCA KOSOVA E RE
NEW KOSOVA ALLIANCE

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>D-V</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>03-2135/10</u>
Nr. I faq Broj stranica <u>2 fage</u>	Data Datum <u>20-05-2010</u>
PRISHTINE	

Zt. Hasan Preteni,

Drejtor i AKK-së

Prishtinë, 19.05.2010

Tema: Deklarimi i pasurisë

I nderuari z. Preteni,

Nuk jam aspak kundër deklaramit të pasurisë gjë që unë rregullisht e bëj tek Agjencioni juaj por pasiqë pranova letrën e juaj jam në dilemë se këtu ekziston një mospajtueshmëri e ligjit.

Është shumë normale që akterët politik të deklarojnë pasurinë e tyre. Rasti im është i veçantë pasiqë një pjesë e të ardhurave të mija përbehet nga shoqëri aksionare anonime gjë që këtu në Kosovë nuk rregullohet me ligj ndërsa në Perëndim, ku unë jetoj, ato janë të rregulluara me ligj.

Të dhënat e mija në shtetin origjinë ku ato janë gjeneruar, mbrohen nga ligji për privatësinë e informatave, të cilat të publikohen vetëm në rast të një persekutimi gjyqësor e kursesi për konsum publik.

Publikimi i të dhënave, ashtu siq i kam deklaruar, është i drejtë dhe është ajo që ju pretendoni në bazë të ligjit por nëse ato publikohen kanë efekt negativ për mua;

- a) Sigurinë time dhe familjarëve të mij,
- b) Janë në kundërshtim me konventat ndërkombëtare.

Prandaj insistoj edhe më tutje që deklarata të mbetet ajo që e kam dhënë por ato të përdoren vetëm në rast të hetimeve sipas paragrafit 5 të nenit 12 ku thuhet se “ Të dhënat që mbahen në regjistër mundë të përdoren dhe procedohen tutje vetëm për qëllime të hetimit dhe parandalimit të korrupsionit apo kontrollit të konflikteve të mundshme të interesit të zyrtarit publik në lidhje me ushtrimin e funksioneve publike”.

Jam dakord që nëse dikush dëshiron të ketë qasje në deklarimet e miya duhet që paraprakisht të ketë nga unë një autorizim për të cilin jam i gatshëm ta bëj sa herë që kërkohet nga unë, nëse ajo kërkesë është legjitime.

Me respekt,

Behgjet Pacolli

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Behgjet Pacolli', written in a cursive style. The signature is positioned to the right of the typed name.